



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2019:178933

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05732046

C.nr.247/16

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri në çështjen juridike kontestimore të paditësit M. U. nga fshati K./Malishevë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “ILLYRIA” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti “Kompensim dëmi”, vlera e kontestit 2,000.00 (dymijë) euro, në seancën e mbajtur me datë 24 maj 2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. **KONSIDEROHET e tërhequr** padia e paditësit M. U. nga fshati K./Malishevë, (lënda me shenjën C.nr.247/16 e datës 27.12.2016), kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “ILLYRIA” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti “Kompensim dëmi”.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

A r s y e t i m

Paditësi M. U. nga fshati K./Malishevë, përmes të autorizuarit të tij Xhevdet Krasniqi avokat nga Prishtina, me datë 27.12.2016, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “ILLYRIA” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti “Kompensim dëmi”, vlera e kontestit 2,000.00 (dymijë) euro.

Lidhur me këtë çështje juridike kontestimore, gjykata me datë 23.02.2024 ka nxjerrë aktvendim për përgjigje në padi dhe të njëjtën ia ka dërguar të paditurës, e cila me datë 14.03.2024 ka kthyer përgjigje duke theksuar se lidhur me dëmin material në automjet të shkaktuar në aksident trafiku me datë 16.08.2015, me paditësin kanë arritur pajtim jashtë gjyqësor me datën 11.05.2022 dhe ka propozuar që ta refuzoj padinë e paditësit si të pabazuar.

Pasi nuk ka pasur ndonjë parashtrësë nga ana e paditësit për pajtim jashtë gjyqësor me të paditurën, gjykata e ka caktuar seancën përgatitore me datë 24.05.2024 me fillim prej orës 10:00, ku asnjëra nga palët nuk ka qenë prezentë.

Në procesverbalin e seancës përgatitore është konstatuar se i autorizuari i paditësit ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt dhe kjo vërtetohet sipas fletë kthesës së datës 17.05.2024, por në seancë nuk është paraqitur askush, mungesën nuk e ka arsyetuar dhe shtyrjen nuk e ka kërkuar, e në të cilën seancë nuk ka qenë prezent askush as nga e ana e të paditurës.

Në rastin konkret, gjykata duke aplikuar nenin 409 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore ku përcaktohet se: *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet”* dhe faktin se paditësi ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, nuk ka prezantuar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, erdhi në përfundim se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, që secila palë t’i bartë këto shpenzime, është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së pasi që secila palë paraprakisht vet i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 409.1 të LPK-së.

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.247/16, datë 24.05.2024

Gj y q t a r i
Petrit Curri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.